



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:229676  
Datë: 18.03.2024  
Numri i dokumentit: 05465926

Ac.nr.5560/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari individual Ylber Shurdhiqi, në çështjen juridike përmbare të kreditorit M.J nga Gjilani, Rr. “S Ç”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson XH.A, avokat nga Ferizaj, kundër debitorit M.R nga Gjilani, Rr. “A T”, nr.8, me objekt të përmbaremit kërkesë në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, CPK.nr.165/21, i datës 08.07.2022, me datë 18.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit M.R nga Gjilani, Rr. “A T”, nr.8, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, CPK.nr.165/21, i datës 08.07.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktvendimin e ankimuar CPK.nr.165/21, të datës 08.07.2022, e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e datës 15.09.2021 të debitorit M.R nga Gjilani, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbaremit P.nr.282/2021 të datës 01.09.2021, të Përmbaremit Privat M. S. SH. nga Ferizaj dhe të njëjtin urdhër e ka lënë në fuqi. Në pikën II të dispozitivit e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e kreditorit që debitorit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor, debitori ka parashtruar ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbaremit, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa e debitorit në tërësi si të bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar të priset dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka nuk ka paraqitur kreditori.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208, 209 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbare, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Përmbareuesi Privat M. S. Sh. nga F. ka lëshuar Urdhrin Përmbare P.nr.282/2021 të datës 01.09.2021, sipas propozimit për përmbare në bazë të Pajtimit Gjyqësor të Gjykatës Themelore në Gjilan me numër të lëndës C.nr.621/2016 të datës 16.02.2021 nga kreditori M.J nga Gjilani, kundër debitorit M.R. nga Gjilani, për shumën prej 75,000.00 euro me kamatë vjetore prej 8 % nga data 03.08.2016 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 1168.00 euro.

Kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbaremit, debitori brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar këtë urdhër përmbare, duke theksuar se vendimi nuk është i formës së prerë pasi nuk e ka as vulën e plotfuqishmërisë e as klauzolën e përmbareshmërisë, andaj nuk ka tipare të përmbareshmërisë fare. Gjykatës, i ka propozuar që të aprovojë në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit dhe të shfuqizojë urdhrin përmbare në fjalë.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim në të cilin ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pabazuar, pasi në pikën II të dispozitivit të aktvendimit me të cilin është lejuar pajtimi gjyqësor janë përshkruar të gjitha obligimet, ndërsa në pikën III është përshkruar klauzola përmbare dhe pajtimi gjyqësor përmban elementet e një dokumenti të pambarueshëm, ndërsa nuk përmban asnjë shkak për prapësim sipas nenit 69 dhe 71 të Ligjit për Procedurën Përmbare. Gjykatës i ka propozuar që të refuzojë prapësimin e debitorit, të lejojë urdhrin përmbare në fjalë dhe t'ia paguajë shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimin, me aktvendimin CPK.nr.165/21, të datës 08.07.2022, ka refuzuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më saktësisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se prapësimi i debitorit i datës 15.09.2021, është i pabazuar, pasi që i njëjti nuk ka vërtetuar asnjëherë nga shkaqet që janë paraparë në nenin 71 të LPP-së lidhur me besueshmërinë e prapësimin, ashtu që gjykata e vlerësoi të pabazuar pretendimin e debitorit se pajtimi gjyqësor nuk përbën dokument përmbare, ngase në nenin 22, paragrafi 1 të po këtij ligji është përcaktuar se “Dokumente përmbare janë: 1.1.vendimi përmbare i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbare”, si dhe në nenin 23, paragrafi 1 të LPP, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdia

gjqësore konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit”.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se Procesverbali i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.621/2016 i datës 16.02.2021 në të cilin është arritur pajtimi gjyqësor ndërmjet kreditorit dhe debitorit, në rastin konkret është dokument përmbarues, kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton se: “*dokument përmbarimor është vendimi përmbarues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbaruese*”, dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21 të LPP-së, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i po këtij ligji ku përcaktohet se: “*dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave ligjore me rastin e refuzimit prapësimit nuk qëndrojnë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë nga pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit i ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera ankimore të debitorit por të cilat nuk kanë qenë me rëndësi vendimtare për të vendosur ndryshe nga ajo që ka vendosur gjykata e shkallës së parë.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se “*në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual*”.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Numri i lëndës: 2021:229676  
Datë: 18.03.2024  
Numri i dokumentit: 05465926

Ac.nr.5560/2022, me datë 18.03.2024

G j y q t a r i,  
Ylber Shurdhiqi